



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT KORÇË

V E N D I M

Nr.27. Datë.03/09/2025

**MBI MIRATIMIN E DHËNIES NË PËRDORIM TË PAISJEVE FONDACIONIT
MISIONI EMANUEL PËR ZHVILLIM DHE INTEGRIM**

Bazuar në ligjin nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, Vendim i Këshillit të Qarkut Korçë nr 51 datë 23.12.2024 “Mbi miratimin e Buxhetit për vitin 2025”, në kuadër të zbatimit të projektiligjit nr 9335 datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore, i ndryshuar, nenin 38 të ligjit 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, VKM 563 datë 12.08.2005”, Për përcaktimin e përgjegjësiave të Qarkut për shpërndarjen e shërbimeve të përkujdesit shoqëror”, VKM 111 datë 23.02.2018 “Për Krijimin dhe Funksionimin e Fondit Social”, në zbatim të projektit: **“Shërbime Sociale e Shëndetësore të Përshtatshme dhe të Integruara për të Moshuarit”**, marrëveshjes së bashkëpunimit midis Këshillit të Qarkut Korçë dhe Fondacionit Misioni Emanuel për Zhvillim dhe Integrim;

VENDOSI:

1. Të miratojë dhënien në përdorim të paisjeve Fondacionit Misioni Emanuel për Zhvillim dhe Integrim, në funksion të Qendrave Ditore Mosha e Tretë Epoka e Artë (sipas listës bashkëngjitur në relacion).
2. Të autorizojë Kryetarin e Këshillit të Qarkut Korçë të nënshkruajë kontratën e huapërdorjes me Fondacionin Misioni Emanuel për Zhvillim dhe Integrim, me afat 2 vjeçar me të drejtë ripërtëritje,
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Financës dhe buxhetit si dhe sektori i projekteve të zhvillimit.

Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit.

KRYETARI
Erjon Nexhipi



Miratuar me 17 / Vota
Vota Pro 17 / Vota
Vota Kundër 0 / Vota
Vota Abstenim 0 / Vota
Zbardhur më datë 03/09/2025

Koncept: P. Lara

Kësh. Juridik: M. Bylykbashi

Sekretar i K. të Qarkut: B. Muço



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT KORÇË

Nr. _____ Prot.

Korçë, më ____ .09.2025

RELACION

MBI MIRATIMIN E DHËNIES NË PËRDORIM TË OBJEKTEVE FONDACIONIT MISIONI EMANUEL PËR ZHVILLIM DHE INTEGRIM

Në kuadër të funksionimit të Programit të Fondit Social, monitoruar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Qarkut Korçë së bashku me Bashkinë Korçë, Pogradec, Maliq në bashkëpunim me Fondacionin “Misioni Emanuel për Zhvillim dhe Integrim” zbatojnë projektin **“Shërbime Sociale e Shëndetësore të Përshtatshme dhe të Integruara për të Moshuarit”**, i cili ka si objekt ofrimin e shërbimeve të specializuara të përkujdesit shoqëror për të moshuarit.

Ky projekt vjen si rezultat i bashkëpunimit disa vjeçar midis aktorëve të sipërcituar, i cili ka si qëllim zgjerimin e nivelit të shërbimeve ekzistuese të përkujdesit shoqëror dhe përfituesve, të ofruara nga Qendrat Ditore të Moshës së Tretë në nivel rajonal.

Në funksion të përmirësimit të kushteve të qendrave Këshilli i Qarkut Korçë ka pranuar dhurimin e disa objekteve nga Banka Kombëtare Tregëtare si më poshtë vijon :

- Karrige personeli x 6 copë
- Tavolina personeli x 6 copë
- Dollap MDF 85.90.40 x 6 copë
- Mbajtëse (tabelë fletëpalosje) x 3 copë
- Pasqyra x 5 copë

Këto objekte do ti lihen në përdorim Fondacionit Misioni Emanuel për Zhvillim dhe Integrim si zbatues i projektit. Ato do të përdoren për mirëfunksionimin qendrave ditore të të Moshuarve Epoka e Artë në Korçë, Pogradec dhe Maliq.

Pajisja e qendrave ditore me mobilim adekuat krijon kushte më të mira për zhvillimin e aktiviteteve sociale, kulturore dhe rekreative për të moshuarit, duke përcjellë një vlerë funksionale dhe sociale të konsiderueshme për komunitetin.

Konceptuar: P.Lara